

	Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo Komuna e Prishtinës Opština Priština –Municipality of Prishtina	PRISHTINA 
---	---	--

Datë/a:	19.04.2023
Referenc-ë:	
Për/ Za/ To:	Zyrtarin Kryesor Administrativ – z. Përparim Rama
CC:	Visar Shehu
Përmes/Preko/Through:	Departamentit për Prokurim
Nga/ Od/ From:	U.D. i Departamentit për Prokurim – z. Visar Shehu
Tema/ Subjekat/Subject:	Akt Përcjellës - Draft Vendim për Shkëputje te kontratës

Me anë të këtij akti, Zyra e prokurimit bazuar ne rekomandimin per shkeputje te kontrates nga menaxheri i kontrates dhe raporti i derguar nga prfaqesuese i OE , ju dergon Vendimin për Shkeputje te kontrates me titull: Renovimi i qendres kulturore ne Llukar, me numer te prokurimit: 616-22-3432-5-2-1.

	Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo Komuna e Prishtinës Opština Priština –Municipality of Prishtina	
---	--	---

Datë/a:	18.04.2023
Referenc-ë:	Kërkesa e menaxherit te projektit për ndërprerje te kontratës
Per	Kontraktuesin "Triangle" Shpk Hyrishahe Morina, Menaxhere e Kontratës
CC:	Arta Balaj, Drejtor i Drejtorisë për Kulturë
Nga/ Od/ From:	Visar Shehu, Udhëheqës i Departamentit te Prokurimit
Tema/ Subjekat/Subject:	Vendim për ndërprerjen e kontratës

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 61.26, 61.27, 61.28 dhe 61.29 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ të Prokurimit Publik që kanë të bëjnë me ndërprerjen e kontratës, ne Rekomandimin për shkëputje te kontratës **06.04.2023** Departamenti i Prokurimit merr:

VENDIM

1. **Nderprehet** kontrata me Operatorin Ekonomik "**Triangle**" Shpk e nënshkruar me datën: -- **30/06/2022**, përfaqësues: **Arijan Bytyqi**, lidhur për aktivitetin e prokurimit "**Renovimi i qendrës kulturore ne Llukar**" me numër te prokurimit: **616-22-3432-5-2-1**.
2. Kontrata nderpehet pa kurrfar kushtesh per kompenzim.
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që ta ndreprej se implementuari kontraten për: "**Renovimi i qendrës kulturore ne Llukar**" me numër te prokurimit: **616-22-3432-5-2-1**, sipas rekomandimit për shkëputje te kontratës nga menaxheri i kontratës.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në web faqen e komunes dhe ne platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

ARSYETIM

Autoriteti Kontraktues - Komuna e Prishtinës me daten **30/06/2022**, ka nenshkuar kontraten per "**Renovimi i qendrës kulturore ne Llukar**" me numer te prokurimit: **616-22-3432-521**.

Bazuar ne rekomandimin per nderprerje te kontrates te dates: 06/04/2023, ne raportin e dates 18/04/2023, AK vendos qe te merr vendim per shkeputje te kontrates. Sipas raporteve dhe rekomandimit per shkeputje te kontrates, arsyet per nderprerjen e kontrates jane:

- a. Punimi – korrigjimi i projektit të ri për qendrën kulturore ne Llukar
- b. Dallimi i madh në mes të para masës së kontraktuar.

AK ka bere përpjekje dhe ka kontaktuar me përfaqësuesin e punë kryesit ku është bere shqyrtimi i dy para masave, para masa e kontraktuar nga AK dhe para masa e prezantuar nga kompania projektuese e qe edhe pas krahasimit te para masave, përfaqësuesit e AK dhe përfaqësuesit e OE kane ardhur ne përfundim qe te behet shkëputja e kontratës për shkak te rritjes se madhe te sasive.

AK Komuna e Prishtinës ne pamundësi për te vazhduar implementimin e projektit ne tërësi merr vendim qe kontrata per **“Renovimi i qendrës kulturore ne Llukar”** te nderprehet pa kurrfar kushtesh per kompenzim.

Bashkangjitur:

Raporti i dt.18.04.2023

Rekomandimi për shkëputje te kontratës i dt. 06.04.2023

Aprovuar nga Zyrtari Kryesor Administrativ
Kryetari i Komunës

Perparim Rama

Zyrtari përgjegjës i prokurimit

Visar Shehu

Vendimi i dërgohet:

Punekryesit ,
Menaxherit të projektit;
Drejtorisë për Arsim; dhe
Departamentit të Prokurimit

-Nexhmi Mekolli

From: Visar Shehu
Sent: 18 April, 2023 08:11
To: Nexhmi Mekolli
Subject: FW: Re:
Attachments: Raport 31.03.2023.pdf

Me respekt,

Visar SHEHU

U.D. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Kabineti i Kryetarit
Komuna e Prishtinës
Tel: 038-200-40-111
Mob: +383 (0) 44-711-111
Email: visar.shehu@rks-gov.net

From: TRIANGLE shpk <triangle.shpk@gmail.com>
Sent: 13 April, 2023 13:17
To: Visar Shehu <visar.shehu@rks-gov.net>
Subject: Re:

Pershendetje

Shpresoj se je mire me shendet, nese mundeni te na njoftoni se ku ka mbet procedura per shkeputje te kontrates ne menyre qe te procedohet me pagese. Ju lutem nese mundeni te e merrni ne prioritet pasiqe pala e demtuar ne kete rast jemi ne, po behen nje vit prej momentit te nenshkrimt te kontrates ku kemi perfunduar punet te cilat jane evidentuar permes menaxheres se projektit , andaj duhet te behet pagesa sepse nuk kemi marre asnje pagese ne kete projekt. Duke e pare volumin e lendeve te juaja shpresoj se kerkesa jone do te kete perparesi. Çdo te mire

On Fri, Mar 31, 2023 at 2:46 PM TRIANGLE shpk <triangle.shpk@gmail.com> wrote:

Pershendetje, shpresoj se jeni mire. Ne atach gjeni raportin nga kompania jone, kemi analizuar ne detaje projektin e ri te prezantuar, ku kemi ndryshime te medha neper pozicione te kontrates baze dhe pozicioneve te reja qe nuk ka çmime referente, mirepo nuk kemi ndonje zgjidhje konkrete nga AK, andaj kerkojme nga ju qe ne afatin sa me te shkurt te nxjerrni ndonje vendim.

On Wed, Mar 29, 2023 at 2:18 PM Hyrishahe Morina <Hyrishahe.Morina@rks-gov.net> wrote:

Përsëndetje të nderuar,

Me shpresë se jeni mirë dhe punët po ju ecin mirë, desha të ju njoftoj se në attach e gjeni të bashkangjitur procesverbalin për kontratën "Renovimi i qendrës Kulturore Llukar" me nr. 616-22-3432-521/C832 të dt. 30.06.2022 të mbajtur sot me dt. 29.03.2023 në ora 09:00 në zyrën e prokurimit.

Me respekt,
Hyrishahe Morina,
Kand Msc e ndërtimtarisë
Zyrtare e Lartë për Ndërtim
Drejtoria për Investime Kapitale dhe Menaxhim të Kontratave
Komuna e Prishtinës

e-mail: hyrishahe.morina@rks-gov.net
tel: 038 23090-lok1205

--
Me respekt:

"TRIANGLE" Sh.p.k.

Adresa: Rr. "Brigada 123" p.n. Suharekë

Tel: 049 (44) / 479 - 341

049 (44) / 473 - 653


--
Me respekt:

"TRIANGLE" Sh.p.k.


Adresa: Rr. "Brigada 123" p.n. Suharekë

Tel: 049 (44) / 479 - 341

049 (44) / 473 - 653



Virus-free www.avg.com



TRIANGLE
DESIGN & BUILD

RAPORT


Data e përgatitjes së Raportit : 31.03.2023

Përgatitur nga: "TRIANGLE" SHPK

AUTORITETI KONTRAKTUES	KOMUNA E PRISHTINËS
NUMRI I PROKURIMIT	616-22-3432-5-2-1
TITULLI I KONTRATËS	Renovimi i Qendrës Kulturore Llukar
VLERE E KONTRATËS	114,243.55 €
PLANI DINAMIK	60 ditë kalendarike


PËR	Menaxheren e projektit: Hyrishahe Morina
CC	Organin Mbikëqyrës
TEMA	Raport

Ngjarjet/Rezultatet e Kontratës	DETAJET E IMPLEMENTIMIT
Njoftim për fillimin e punimeve	25.07.2022
Afati për sjelljen e mostrave nëse është e aplikueshme	Të gjitha mostrat e materialeve do të sillen para vendosjes së materialeve.
Pagesat e përkohshme apo në faza	-Nuk është bërë asnjë pagesë
Inspektimi punimeve dhe materialeve	- Punimet kanë filluar me kohë sipas kontratës me datën 25.07.2022, ku janë realizuar disa pozicione për këto ditë sa është punuar: - Shkyqja e perkoheshme e instalimeve ekzistuese.... - Instalimi i zyres së perkohshme ... - Demolimi i tersishem i kulmit... - Demolimi i inventarit në gjithë hapsirën e brendshme, bines - Demolimi i tersishem i dyshmese në gjithë hapsirën ... - Demolimi i tersishem i bibliotekës dhe bartja e librave në vend të sigurt... - Demolimi i tersishem i pllakes së trajtuar në pllaken e bibliotekës ... - Demolimi i tersishem i shkalleve nga betoni dhe tarases ... - Germimi i dheut përreth hapsirës së objektit....



TRIANGLE
DESIGN & BUILD

Fotot e punimeve





TRIANGLE
DESIGN & BUILD

Me date 28.07.2022 eshte mbajtur takimi ku edhe jane evidentu problemet ne lidhje me realizimin kesaj kontrate, prej kesaj date nuk jane zhvilluar punime ne teren.

Kemi mbajtur takime te shpeshta per te gjetur formen se si te perfundohet ky projekt. Pas disa varianteve te bera nga kompania projektuese pasi qe projekti ekzistues dhe paramasa kane qene te mangeta me gjendjen ekzistuese te objektit ne teren.

Pas takimit te mbajtur me date 14.03.2023 u prezantua projekti i ri nga kompania projektuese ku edhe ka hartuar paramasen dhe parallogarinë sipas atij projekti. Ku ne kemi marr kete projekt dhe e kemi analizuar ne detaje pasi qe shume sasi te materialeve rriten mirepo krijohen edhe shume pozicione tjera te reja qe nuk kemi çmime per ato pozicione.

Ne takimin e mbajtur me 29.03.2023 u diskutua te gjindet forma se si te procedohet me tutje, mirepo ende pas asnje rezultat.

Po shpegoj disa pozicione qe kompania projektuese i ka parapare te punohen mirepo ne në kontraten baze kemi pozicione tjera(pershkrim tjeter):

-Punet e betonimit ne kontraten baze i kemi ne themele shiritore dhe betonimin e pllakes, ndersa ne projektin e ri kemi themele te vequara dhe themele shiritore, shtylla, traje etj, ku ndryshon çmimi per realizueshmerine e ketyre pozicioneve qe duhet te krijohet tjeter çmim.

-Ku pozicioni i betonit rritet ne perqindje 47.2 %

-Pozicioni i armatures rritet per 61 %

-Pozicioni i konstruksionit te hekurit per kulm rritet 69% dhe shume pozicione tjera qe ka nevojte te rriten sipas projektit te ri

Gjitashtu ne projekt te ri jane parapare pozicione te cilat nuk i kemi ne kontraten baze siq jane:

-Muratimi me blloka 25 cm

-Punimi i oxhaqeve ne kthina

-Punimi i suvatimit te jashtem dhe te brendshem

-Punimi i gletimit


-Punet e llamarines

-Shtohen dritare te reja

-Ndryshon dimensionin e dritareve edhe dyerve prej kontrates baze

-Punimi me pllaka te granitit

-Punet e jashtme me te gjitha shtresat dhe vendosje te kubezave, etj



TRIANGLE
DESIGN & BUILD

Te gjitha keto pozcione te reja qe jane parapare nga projektuesi, nuk ka çmime referente ne kontrate andaj duhet te negociohen si teresi ne vlerë mbi 65,000 €

Duke pare veshtiresite e gjetjes se ndonje varianti per te vazhduar me tutje, si dhe zgjatjen e kesaj kontrate, propozojme qe te shkepusim kontraten ne marreveshje dypaleshe ne te mire te projektit.

Punëkryesi: " **TRIANGLE** " shpk

Nexhmi Mekolli

From: Visar Shehu
Sent: 18 April, 2023 08:10
To: Nexhmi Mekolli
Subject: FW:
Attachments: Akti pëecjellës dhe konstatimi për ndërprerje të kontratës për Renovimi i qendrës Kulturore LLukar.pdf

Me respekt,

Visar SHEHU

U.D. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Kabineti i Kryetarit
Komuna e Prishtinës
Tel: 038-200-40-111
Mob: +383 (0) 44-711-111
Email: visar.shehu@rks-gov.net

From: Hyrishahe Morina

Sent: 13 April, 2023 13:01

To: Visar Shehu <visar.shehu@rks-gov.net>; Arta Balaj <arta.balaj@gjk-ks.org>; Krenar Xhaferi <Krenar.Xhaferi@rks-gov.net>

Cc: Ferit Fazliu <Ferit.Fazliu@rks-gov.net>; Syzana Pllana <Syzana.Pllana@rks-gov.net>; Lindita Cervadiku Dibra <lindita.cervadiku.dibra@rks-gov.net>; Nazmije Tora <Nazmije.Tora@rks-gov.net>; TRIANGLE shpk <triangle.shpk@gmail.com>; Bashkim Statovci <bashkim.statovci@rks-gov.net>

Subject:

Përschendetje të nderuar,

Me shpresë se jeni mirë, dhe punët po ju ecin mirë, desha të ju njoftoj se në attach e gjeni të bashkangjitur raportin e Rekomandimit për ndërprerjen e kontratës "Renovimi i qendrës Kulturore në Llukar" me nr. 616-22-3432-521/C832 dt. 30.06.2022. të cilën do e kemi edhe në kopje fizike.

Me respekt,

Hyrishahe Morina,
Kand Msc e ndërtimtarisë
Zyrtare e Lartë për Ndërtim
Drejtoria për Investime Kapitale dhe Menaxhim të Kontratave
Komuna e Prishtinës

e-mail: hyrishahe.morina@rks-gov.net
tel: 038 23090-lok1205



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina

Datë/a:	06.04.2023
Referenc-ë:	kontrata nr.616-22-3432-521/C832
Për/ Za/ To:	Zyrës së prokurimit Drejtorisë së Kulturës Qendrës për shërbim me qytetar OE –“Triangle” sh.p.k rr. Brigada123, Suharekë DIKMK
CC:	Drejtorit Krenar Xhaferi
Nga/ Od/ From:	Menaxheri: 1.Hyrishahe Morina, Mbikëqyrës i menaxherit të projektit Nazmije Tora Organi mbikëqyrës 1.Lindita Cervadiku 2.Bashkim Statovci 3.Syzanna Pllana
Tema/ Subjekat/Subject:	REKOMANDIM PËR NDËRPRERJE TË KONTRATËS “Renovimi i qendrës Kulturore Llukar” nr. 616-22-3432-521/C832

Kontraktues; “OE –ik: “Triangle” sh.p.k

Vlera e kontratës 114,243.55€

REKOMANDIM

Rekomandoj iniciimin e procedurës për shkëputjen e kontratës nr. Prokurimit 616-22-3432-521/C832, “Renovimi i qendrës Kulturore Llukar”

Menaxheri, Mbikëqyrësi i Drejtëpërdrejtë i Menaxherit(MDM), organi mbikëqyrës po edhe OE, pas nënshkrimit të Planit të Menaxhimit dhe organizimit të fillimit të punëve, pas analizimit të paramasës dhe projektit kanë konstatua mangësi në projekt gjë, që vështirë të mundemi me realizua at objekt.

Meqenëse MDM , është arkitekt me profesion kemi angazhuar për kontrollimin e projektit në aspektin arkitektonik dhe unë në aspektin strukturor.

MDM z. Nazmije Tora, arkitekte, pas kontrollit të projektit ka konstatuar këto vërejtje në projekt:

- Fillimisht nuk ka pas incizim gjeodezik, për të konstatuar gjendjen reale, por është punuar sipas matjeve nga gjeoportali dhe dimensionet reale të objektit me gjendjen në projekt

janë të ndryshme, gjë që ndikon në ndryshimin e sasisë së materialeve të përllogaritura sipas pozicioneve në kontratë.

- Duke pas parasysh karakterin e objektit objekt Kulturor, dhe ndoshta edhe objekt i mbrojtur, projekti i hartuar nuk përket aspak me gjendjen reale, as nuk është ruajtur pamja e saj duke intervenuar në renovimin e saj, elementet e reja të propozuara krijojnë një disharmoni në pamjen e objektit, derisa thuhet të ruhet fasada e objektit, fasada e objektit e dimë që përfshin, kulmin, strehën, mbulesën e kulmit, hapjet në fasadë dhe vet murin e fasadës.
- Nëse shikohet projekti, nuk është ruajtur pamja e objektit në tërësi, komplet pjesa e kulmit është ndryshuar, si nga pamja, konstruksioni dhe mbulesa. Konstruksioni i kulmit është punuar konstruksion Kapriatë, dhe mbulesa panel sendëvich, i cili ka ndryshuar ramjen e kumit dhe zgjidhjen arkitektonike të kulmit, duke parë se në teren kulmet kanë disnível në mes veti dhe lidhja e këtyre dy kulmeve, në pikat kritike është e vështirë.
- Hapjet në fasadë, janë propozuar PVC antracit në pjesën e jashtme e cila nuk inkorporohet me gjendjen e objektit, dyert e brendshme janë paraparë dyer PVC, të cilat te këto lloje të objekteve nuk përkrijnë.
- Janë planifikuar rampa të panevojshme në pjesën lindore.
- Fasada nuk është paraparë të intervenohet, por vetëm të plotësohet aty ku është e nevojshme, e sa i përket kësaj, më se e dëmtuar dhe e shëmtuar është fasada, e cila nuk lejohet mos intervenimi në fasadë, e kësaj kur i shtohet edhe elementi termik, që sot nuk lejohet që objekt të jenë pa izolim termik.
- Në pjesën e bibliotekës dysHEMEJA është paraparë keramik, e cila nuk është e preferuar për këtë lloj aktiviteti
- Plafoni i objektit është paraparë Amstrog pllaka, të cilat nuk është paraparë konstruksioni por edhe nuk është menduar akustika, sikur edhe te muret nuk janë punuar në elementin e izolimit akustik.

Në aspektin strukturor, si menaxhere ashtu edhe OE ka konstatuar shumë mangësi, që është i pamundur realizimi i saj.

Vetëm në përshkrim kemi disa elemente që përshkruhen, kurse nuk kemi elaborat të strukturës së objektit. Të gjitha janë vetëm propozime dhe nuk ka asnjë element të përllogaritur dhe të përshtatura me objektin.

- Përforcimi i propozuar i themeleve është totalisht i pa përllogaritur dhe nuk ekziston asnjë detal, që mund të bazoheshim për realizimin e tyre.
- Propozimi- përshkrimi i trajeve dhe dimensionit, nuk përkrijnë me realitetin dhe është i pamundur
- Propozimi për kulm – me kapriatë, nuk ekziston asnjë detal dhe nuk ka llogaritje të elementeve të kapriatës, nuk dihet forma, nuk dihen dimensionet, nuk dihet lartësia, nuk ka asnjë prerje të objektit ku mund të shihet forma e kapriatës, kjo e ndryshon komplet lartësinë e objektit dhe formën e kulmit.
- Shkruan përforcimi i brendshëm i themeleve që nuk ka asnjë detal si do të realizohet dhe në çfarë madhësie – asnjë dimension
- Në paramasë edhe pse është paraparë keramika, nuk ka sasi të mjaftueshme
- Në pozicionin C. Punët ndërtimore zejtare, poz.2 dhe 3, është i përshkruar, por nuk është prezantuar asnjë detal se si do të ekzekutohet
- Në poz.D Punët e betonit, poz.1,2 betonimi i themeleve shiritore dhe pllakës, nuk kemi asnjë llogaritje statike asnjë detal për ekzekutim
- Poz. 3, te punët e betonit – betonimi i trajeve 30/40, kur muret janë 60cm dhe në formën e përshkruar nuk mund të realizohen, por edhe nuk kemi detal si do të realizohen.
- Nuk dimë si është përcaktuar sasia e armaturës kur nuk ka llogaritje statike por vetëm përshkrim në pozicione 1,2,3, te punët e armaturës

- Te punët e keramikës, nuk është paraparë sasia e keramikës për dy kthina te biblioteka dhe te studio
- Te poz. Punët e Plafonit, dy pozicionet 1 dhe 2, janë me përshkrim të njëjtë, dhe sasi të njëjtë, kurse OE, ka vë çmime të ndryshe, të njëra 6€ dhe te tjetra 0.05€.
- Te poz. Elementet Sanitare, gjithashtu përsëriten pozicionet nga dy here por me çmime të ndryshme, për të cilat pozicione nuk mundemi të gjejmë një zgjidhje sepse ne kërkoj që pagesa të bëhet me çmimin më të ulët kurse OE me çmimin më të lartë.

Në teren OE ka filluar realizimin e punëve; është vendos kontinjeri, ka filluar me punime ku është bërë:

1. Shkrycja e përkohshme e instalimeve ekzistuese,
2. Instalimi i zyrës së përkohshme,
3. Demolimi i tërësishëm i kulmit,
4. Demolimi i inventarit në hapësirën e brendshme,
5. Demolimi i tërësishme i dyshemesë,
6. Demolimi i tërësishëm i bibliotekës dhe bartja e librave në vendin e caktuar,
7. Demolimi i tërësishëm i pllakës së bibliotekës,
8. Demolimi i pjesërisht i shkallëve nga betoni dhe tarasaes.

Intervenimet në projekt sipas OE dhe sipas organit mbikëqyrës, drejtëpërdrejtë shkaktojnë ndryshime në pozicionet në kontratë, andaj meqë janë të shumta, ato ndikojnë në ndryshimin e kushteve të kontratës, dhe si të tilla nuk mund të procedohen pa marrjen e pëlqimit apo plotësimit të projektit, ku pas shumë takime të mbajtura të një pas njëshme me drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale, Drejtoreshën e Drejtorisë së Kulturës, OE – Triangle sh.p.k. si dhe organin mbikëqyrës kemi ardhur në përfundim që të bëhet një projekt i ri, ku me përfundimin e projektit të ri janë shtuar disa pozicione si dhe rritur disa sasi.

Pas përfundimit të komplet projektit kemi mbajtur një takim në drejtorin e prokurimit me dt.29.03.2023 në ora 9:00 ku prezent ishin:

- Krenar Xhaferi drejtor i Investimeve Kapitale dhe Menaxhim të Kontratave,
- Visar Shehu ud (drejtor) i prokurimit,
- Ferit Fazliu shef. Sektori në drejtorin e Investimeve Kapitale dhe Menaxhim të Kontratave-sektori i ndërtimit të lartë,
- Hyrishahe Morina menaxhere e kontratës,
- Lindita Cervadiku organ mbikëqyrës e kontratës dhe
- Arjan Bytyqi-përfaqësues i kompanisë "Triangle" sh.p.k.

Pasi diskutuam të gjitha vërejtjet e cekura në projekt dhe paramasë erdhëm në përfundim se të vazhdohet me punime deri në vlerën e kontratës si dhe një rritje 10% e kontratës, pasi të kryhet vlera e kontratës si dhe rritja me 10% pastaj duhet të shkojmë me një kontratë të negociuar.

Gjithashtu u diskutua edhe për pozicionet e njëjta me çmime të ndryshme, për këto pozicione u vendos që puna të kryhet 50% te njërit pozicion dhe 50% të pozicionit tjetër.

OE- triangle sh.p.k pas takimit të mbajtur ka bërë shqyrtimin e dy paramasave, paramasen e tenderuar dhe paramasen të cilën e ka prezantuar kompania projektuese "Taulanti sh.p.k. dhe Studio Hapësira sh.p.k" e që pas krahasimit të këtyre paramasave ka ardhur në përfundim që të bëjë shkëputje të kontratës ngase nuk mundë ti përballoj ndryshimeve të pozicioneve dhe rritjeve të sasive.

Bazuar në të thënat ma lartë kemi konstatuar se kjo kontratë është e parrealizueshme, dhe për arsyet e cekura më lartë rekomandojmë shkëputjen e kësaj kontrate.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina



Datë/a:	06.04.2023
Referenc-ë:	nr. 616 22 3432 521/C832 dt. 30.06.2022
Për/ Za/ To:	Departamentin e Prokurimit
CC:	OE-Triangle sh.p.k Drejtorin e Kulturës Qendra për komunikim me qytetarë, Në Lëndë
Përmes/Preko/Through:	Drejtorisë së Investime Kapitale dhe Menaxhim tëkontratave
Nga/ Od/ From:	Hyrishahe Morina-Zyrtare e Lartë për ndërtim Menaxhere e kontratës
Tema/ Subjekat/Subject:	Akt Përcjellës

Përmes këtij akti ju dërgojmë Rekomandimin për ndërprerje të Kontratës „Renovimi i qendrës Kulturore Llukar“ me nr. 616 -22-3432-521/C832 dt. 30.06.2022.